

VENDIM
Nr. 148, datë 26.11.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGIJ” SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energi” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gerrat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Liria Energi” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti